

URDHËR
Nr. 2027, datë 4.10.2013

**PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR SUBJEKTIN “PAYLINK” SHA SI OPERATOR SKEME
KOMBËTARE TË PAGESAVE ME KARTË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 9, pika 3 të statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 100, datë 19.12.2000 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, nenit 2, paragrafi 1, nenit 6, paragrafët 1 dhe 2, nenit 14 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013 “Për sistemin e pagesave”, të neneve 7, 9, 10 dhe 14 të rregullores “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë”, miratuar me vendimin nr. 42, datë 26.6.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave,

URDHËROJ:

1. Miratimin e licencës për subjektin “Paylink” sh.a. për të vepruar si “Skemë kombëtare e pagesave me kartë” në Republikën e Shqipërisë, sipas formatit bashkëlidhur.
 2. Veprimtaritë e lejueshme për operatorin “Paylink” sh.a. përshkruhen në aneksin bashkëlidhur licencës.
 3. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave për komunikimin e këtij urdhri operatorit dhe me mbikëqyrjen e veprimtarisë së tij.
 4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e licencës në Fletoren Zyrtare, në Buletinin Zyrtar, si dhe në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR
Ardian Fullani

LICENCË
Nr. 1, datë 4.10.2013

OPERATOR SKEME KOMBËTARE TË PAGESAVE ME KARTË

Në bazë të nenit 2, paragrafi 1, nenit 6 paragrafët 1 dhe 2 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.4.2013 “Për sistemin e pagesave”, të neneve 7, 9 dhe 10 të rregullores “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë”, miratuar me vendimin nr. 42, datë 26.6.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, “PAYLINK” sh.a. me seli qendrore në bulevardin “Zogu I”, pallati “Edicom”, kati i 13-të, Tiranë, i jepet licenca për të vepruar si OPERATOR SKEME KOMBËTARE TË PAGESAVE ME KARTË në Republikën e Shqipërisë.

Licenca i lejon operatorit “PAYLINK” sh.a. të kryejë veprimtaritë e përshkruara në aneksin bashkëlidhur.
Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme.

ANEKSI I LICENCËS
VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR OPERATORIN “PAYLINK” SHA

- Veprimtaria e “Skemës kombëtare të pagesave me kartë” përfshin të gjitha aktivitetet e mëposhtme:
- a) administrimin e përgjithshëm të skemës;
 - b) mbështetjen e emetimit të kartave, nëpërmjet prodhimit dhe personalizimit të tyre, procesimit të të dhënave, vërtetimit (*authentication*) dhe autorizimit;
 - c) mundësimin e përdorimit të kartave në ATM, terminale POS (POS/EFTPOS) terminale virtuale POS (virtual POS) etj.;
 - d) administrimin e veprimeve në терминалет e mësipërme për kryerjen e transaksioneve, duke përfshirë edhe prodhimin e të tilla pajisjeve;
 - e) pranimin dhe shërbimet e komunikimit për kryerjen e transaksioneve; dhe
 - f) klerimin e pagesave me kartë (përfshirë edhe infrastrukturën e nevojshme për shlyerjen e transaksioneve me kartë).

Operatori “Paylink” sh.a. mund të kryejë, nëpërmjet palëve të treta, vetëm aktivitetet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “d”.

GUVERNATOR
Ardian Fullani